



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 646/9 Prot.

Tiranë, më 29.01. 2016

V E N D I M

Nr. 14, datë 29.01.2016

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 646/1 prot., datë 08.10.2015”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë, për pretendimet e parashtruara nga nëpunësja *****, se në rastin e saj vërehen aspekte të menaxhimit të shërbimit civil në kundërshtim me ligjin,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit nr. 646/1 prot., datë 08.10.2015, pasi është shqyrtuar informacioni i marrë nëpërmjet shkresës së dërguar nga nëpunësja e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, ***** , protokolluar me nr. 646/1, datë 08.10.2015, u krye verifikimi i ligjshmërisë në lidhje me respektimin e të drejtave në cilësinë e nëpunëses civile nga ana e subjekteve të njohura me ligj për administrimin e shërbimit civil në lidhje me mënyrën e pagesës për detyrën që kryen, si e komanduar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të rrethanave të këtij rasti, ka rezultuar:

Punonjësja ***** ka filluar punë për herë të parë, pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, me aktin e emërimit nr. 288 prot., datë 18.02.2011, “Emërim specialiste”, nxjerrë nga Drejtori i Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë”, me nivel page IV-b, (për shkak se, sipas legjislacionit të kohës, ky institucion nuk përfshihej në shërbimin civil).

Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në bazë të nenit 67 të tij dhe Kreut III, pika 1, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e

nëpunësit civil”, me “Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit” nr. 2116/25, datë 14.08.2014, të lëshuar nga Departamenti i Administratës Publike, me cilësinë e njësisë përgjegjëse, kjo punonjëse ka fituar për shkak të ligjit, statusin “*Nëpunës civil*”, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë*”, në Drejtorinë Arsimore, Rajonale, Tiranë.

Në kuadër të zhvillimit të karrierës, në datën 18.08.2015, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, kjo nëpunëse është shpallur fituese dhe është emëruar nga Departamenti i Administratës Publike, në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë*”, në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë, kategoria e pagës IV-a.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton që kjo punonjëse, ndërkohë që ka qënë e punësuar në pozicionin e punës “*Specialiste në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë*”, në muajin Maj 2014, me anë të shkresës nr. 3642/3 prot., datë 27.05.2014, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për nevoja urgjente të punës, është ngarkuar të kryejë detyrën e Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë. Ky akt është diktuar nga fakti se, drejtuesja e mëparshme e kësaj drejtorie ishte pezulluar nga puna për shkak të nisjes së një ecurie disiplinore, ecuri e cila ka përfunduar me aktin nr.15, dt.16.06.2014, me largimin e saj nga detyra.

Me mbarimin e afatit të komandimit nëpërmjet aktit të mësipërm, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë, me aktin nr. 3642/8, datë 14.07.2014, të Sekretarit të Përgjithshëm, nëpunësja ***** është ngarkuar përsëri të kryejë detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, për një periudhë tjetër, 6 mujore.

Rezulton se edhe pas mbarimit të këtij afati 6 mujor, me shkresën nr. 605 prot., datë 27.01.2015, të Sekretarit të Përgjithshëm, është urdhëruar përsëri, që kjo punonjëse, “...ngarkohet që të kryejë përkohësisht, detyrat e Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë”, por këtë herë pa afat të përcaktuar.

Në të gjitha rastet e përmendura më sipër, ku punonjësja ***** është komanduar të kryejë këtë detyrë, rezulton se, si motiv janë paraqitur nevojat urgjente të punës, për shkak të veçorisë dhe kompleksitetit të natyrës së funksionit të Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë. Nga ana tjetër konstatoj se, duke u konsultuar me procedurat ligjore të kërkuara në kushte të tilla, rezulton se këto transferime të njëpasnjëshme janë kryer në shkelje të kërkesave të përcaktuara në nenin 48, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në përmbajtjen e kësaj dispozite përcaktohet se: “*Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori...*”. Nga administrimi i provave rezulton se, në momentin e komandimit në detyrën “*Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale, të Qytetit Tiranë*”, nëpunësja ***** ka qënë në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë*”, që i përket nivelit ekzekutiv, ndërkohë që pozicioni në të cilin është komanduar i përkiste nivelit të mesëm drejtues, nga ku rezulton se në këtë transferim të përkohshëm të nëpunëses, nuk është respektuar kriteri i ruajtjes së kategorisë.

Veç kësaj, dispozita e mësipërme, ka përcaktuar se: “*Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht (...a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj, gjatë 2 viteve; Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozicionin e mëparshëm*”.

Nga verifikimi ka rezultuar se nga ana e Ministrisë së Arsimit kemi një mosrespektim të kërkesave ligjore, pasi duke analizuar aktet e njëpasnjëshme të komandimit/transferimit të nëpunëses, konstatohet se afati i caktuar në ligj, është tejkaluar në mënyrë të dukshme (*Nga momenti i transferimit për herë të parë e në vazhdim, kanë kaluar më shumë se 20 muaj*).

Shkelja e afateve të transferimit të përkohshëm është shoqëruar edhe me tejkalimin e kompetencës nga ana e organit që ka urdhëruar komandimet, pasi me të drejtën e transferimit të nëpunësve civilë në institucionet qendrore dhe institucionet në varësi të tyre, ligji ngarkon njësinë përgjegjëse, që në këtë rast është Departamenti i Administratës Publike. Në nenin 52, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në lidhje me këtë thuhet shprehimisht (...) - "*Vendimi për transferimin merret nga njësia përgjegjëse, Në rastin e institucioneve të administratës qendrore, njësia përgjegjëse vendos edhe me kërkesë të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku ai është i punësuar*". Në kundërshtim me dispozitën e mësipërme, shkresat për komandimin e nëpunëses në fjalë, janë nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, duke anashkaluar kompetencën e Departamentit të Administratës Publike.

Nga sa u analizua më lart, çmoj se këto akte janë absolutisht të pavlefshme, pasi në to nuk është respektuar asnjë nga kërkesat e ligjit, si për periudhën e transferimit, ashtu edhe për ruajtjen e së njëjtë kategori, nivel i mesëm drejtues, çfarë konsiderohet si një shkelje shumë e rëndë.

Këto veprime, sipas shpjegimeve të dhëna nga njësia e burimeve njerëzore të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, janë diktuar nga fakti se punonjësja e mëparshme që mbante pozicionin e punës "*Drejtores e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë*", e kishte ankimuar aktin e dhënies së masës disiplinore dhe ekzistonte mundësia që organet gjyqësore, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, të vendosnin kthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës.

Ky është një perceptim i gabuar i problemit pasi, në legjislacionin aktual të shërbimit civil, nuk parashikohet ruajtja e vendit të punës në një rast të tillë. Që nga momenti i daljes së Vendimit të Komisionit të Disiplinës të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve me nr. 15, datë 16.06.2014, me të cilin është vendosur largimi nga detyra i Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë, ky pozicion në kuptim të ligjit është i lirë dhe njësia e burimeve njerëzore, në mënyrë aktive, duhej të niste procedurën për plotësimin e këtij vendi vakant, duke paraqitur kërkesën pranë Departamentit të Administratës Publike, për kryerjen e procedurës së konkurrimit.

Përsa i përket pretendimit të nëpunëses mbi zgjidhjen e problemit se cilën pagë duhet të marrë për kohën e komandimit në detyrën e Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë, kjo është një e drejtë që i takon institucionit dhe Departamentit të Administratës Publike, të cilët e vlerësojnë rastin dhe mbajnë qendrimin e tyre ligjor.

Komisioneri, në lidhje me këtë pretendim, vlerëson se problemi i pagës duhet të ishte shprehur në momentin e daljes së aktit të transferimit, duke përcaktuar njëkohësisht edhe efektin financiar në lidhje me këtë detyrë. Fakti që, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është çmuar që të mos ketë efekt financiar në lidhje me ndryshimin e pozicionit të punës për këtë nëpunëse, nuk përbën shkelje të dispozitave dhe përcaktimeve të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15, 34, dhe 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 16, pikat 5, 8 dhe 9, si dhe nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit,

VENDOSA

Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, me cilësinë e njësisë përgjegjëse:

1. Të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë, duke respektuar procedurën e plotësimit të tij, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë dhe nëpunësja *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA